



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKTLIGJ

NR ____/2019

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10242, DATË 25.2.2010 “PËR
INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZIMIT NË
SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
me propozimin e një grupi deputetësh

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e
Komunizimit në Shqipëri”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11, pika 1, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Shkronja ç ndryshohet me këtë përmbajtje:

“ç. propozon në Kuvendin e Shqipërisë strukturën dhe organikën e institucionit;

2. Pas shkronjës ç shtohet shkronja ç/1 me këtë përmbajtje:

“ç/1. propozon në Këshillin e Ministrave buxhetin vjetor të institucionit;”

Neni 2

Në nenin 19, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Struktura dhe organika e punonjësve të institutit miratohen me vendim të Kuvendit të
Shqipërisë.”

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Ngarkohet Kuvendi i Shqipërisë të miratojë strukturën dhe organikën e Institutit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 të këtij ligji brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji..

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10242, DATË 25.2.2010 “PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZIMIT NË SHQIPËRI”

I. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTAKTIT

Projektligji propozohet për të unifikuar dhe harmonizuar praktikën e miratimit të strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për institucionet e pavarura dhe ato të krijuara me ligj.

Bazuar në Ligjin Nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar struktura dhe organika e institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj, miratohen me vendim të Kuvendit, në bazë të numrit të miratuar në zbatim të ligjit vjetor të Buxhetit të Shtetit, për secilin institucion.

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri është institucion publik, qendror, i pavarur, gëzon statusin e personit juridik dhe financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera.

Ligji nr.10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e në Shqipëri” ngarkon Kuvendin e Shqipërisë me detyrën dhe përgjegjësinë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Institutit si dhe shkarkimin e tyre në rastet e përcaktuara në ligj. Instituti raporton në Kuvendin e Shqipërisë mbi veprimtarinë vjetore të tij.

Ndonëse buxheti i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, si pjesë e Buxhetit të Shtetit, shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend, struktura, organika dhe niveli i pagave të tij nuk miratohen me vendim të Kuvendit, por me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në Ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, Institutit iu akordua nga Kuvendi fondi për katër pozicione të reja pune, i cili çoi në konceptimin e një strukture dhe organike të re. Kjo strukturë dhe organikë e re ende nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 19, pika 2 e ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit në Shqipëri”: *Struktura, organika dhe niveli i pagave të punonjësve të Institutit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.* Mosplotësimi i strukturës dhe organikës me numrin e punonjësve të planifikuar, ka sjellë që kjo pjesë e buxhetit të mbetet e porealizuar nga Instituti. Për pasojë nga problematikat kryesore të këtij instituti vazhdon të mbartet dhe vijon të jetë numri i pamjaftueshëm i punonjësve, krahasuar me volumin e punës që i duhet të kryejë në përputhje me detyrat që i ngarkon ligji. Ndërkohë që aktiviteti sa vjen dhe bëhet më ambicioz dhe më i gjerë, duke shtuar jo vetëm nevojën e zgjerimit të stafit, por edhe të profileve profesionale.

Në mbështetje të veprimtarisë së këtij institucioni si dhe në harmoni me ligjet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve të pavarura dhe ato të krijuara me ligj, nëpërmjet kësaj

nisme ligjore propozohet që, organika dhe niveli i pagave të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit në Shqipëri të miratohen nga Kuvendi i Shqipërisë.

II. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucioni që ngarkohet me zbatimin e këtij projektligji është Kuvendi i Shqipërisë, i cili brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij projektligji, duhet të miratojë strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

III. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, si dhe është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e vendit në fuqi.

Adnan Shkurtaj
Alket Hyseni
10/9